



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 181 Akti**

**Nr. 201 Vendimi**  
**Tiranë, më 25.10.2019**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Kryesuese
<b>Suela Zhegu</b>	Anëtare
<b>Etleda Çiftja</b>	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prezencë edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Mia Roessingh, në datën 21 tetor 2019, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i 0 (zero), zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Sonila Muhametaj (Domi), prokurore pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.**

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016,** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015,** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012,** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Sonila Muhametaj (Domi), dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT PROCEDURALE**

1. Znj. Sonila Muhametaj (Domi) është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Znj. Sonila Muhametaj (Domi) bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 17.9.2019 me trupin gjykues të përbërë nga komisioneret:

Genta Tafa (Bungo)

Suela Zhegu

Etleda Çiftja

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP) sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin nr. 1, datë 24.9.2019, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit; të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Genta Tafa (Bungo). Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, në datën 7.10.2019, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, znj. Sonila Muhametaj (Domi), bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar bashkë me nenet D, DH dhe E, të Aneksit të Kushtetutës; (iii) të njoftojë subjektin

e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

6. Në datën 7.10.2019, përmes postës elektronike<sup>1</sup>, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda datës 10.7.2019; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 11.10.2019, po përmes postës elektronike<sup>2</sup>, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit në lidhje me vendimin nr. 3, të trupit gjykues “ndryshimin e rezultateve të hetimit”, duke i shtuar një denoncim nga publiku.

8. Në datën 17.10.2019, me vendimin nr. 4, trupi gjykues vendosi të refuzojë kërkesën e subjektit për thirrjen si dëshmitarë të shtetasve E.M., A.B. (M.), O.Z. (M.), S.A., R.R., E.G. dhe A.C., pasi referuar germës “b”, të pikës 6, të nenit 49, të ligjit 84/2016, faktet të cilat u kërkuan të provoheshin ishin të parëndësishme për vendimmarrjen.

9. Po në vendim nr. 4, datë 17.10.2019, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Sonila Muhametaj (Domi), në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Përmes postës elektronike subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 16.7.2019, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i I-rë, Tiranë.

10. Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Sonila Muhametaj (Domi), bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

11. Në datën 21.10.2019 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit edhe në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Mia Roessingh, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

12. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni, përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit – dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

13. Znj. Sonila Muhametaj (Domi), pasi dëgjoji relacionin shprehu qëndrimin e vet, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.

---

<sup>1</sup> E-mail datë 7.10.2019, ora 2:36, “Komisioni – Njoftim për mbylljen e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

<sup>2</sup> E-mail datë 11.10.2019, ora 11:25, “Amendimi i rezultateve të hetimit”.

14. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin, znj. Sonila Muhametaj (Domi), duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.

15. Seanca dëgjimore e datës 21.10.2019, u ndërpre, për të rifilluar në datën 25.10.2019, për shpalljen e vendimit.

16. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 21.10.2019, subjekti i rivlerësimit, znj. Sonila Muhametaj (Domi), kërkoi konfirmimin në detyrë.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

17. Subjekti i rivlerësimit, znj. Sonila Muhametaj (Domi), ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

18. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

- i. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror.
- ii. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit.
- iii. Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organi përkatës i vlerësimit profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjorë të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

19. Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>3</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli

---

<sup>3</sup> Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2, të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## **V. RIVLERËSIMI I PASURISË**

### **V/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

20. ILDKPKI-ja, me raportin nr. \*\*\*, datë 16. 7.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Sonila Muhametaj (Domi), e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2006, me nr. indeksi \*\*\* dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

21. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2006 deri në vitin 2016 dhe në datën 27.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

### **V/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI nga viti 2006 deri në 2016; (d) provat shkreore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (e) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

23. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim;

dhe (iv) në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

### **Personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar**

24. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur, apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë si më poshtë vijon:

24.1 Z. E.M. – bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person i lidhur.

24.2 Z. E.Sh.D. – vëllai i subjektit të rivlerësimit – për shkak të dhënies hua në vlerën 500.000 lekë

24.3 Znj. E.Sh.G. (D.) – motra e subjektit dhe B.G., bashkëshorti i motrës së subjektit - për shkak të dhënies hua të vlerës 1.000.000 lekë.

24.4 Znj. B.M. – e vjehrra e subjektit - për shkak të: financimit të shumës 400.000 lekë për blerjen e një apartamenti në emër të saj; financimit të shumës 764.000 lekë për arredimin e këtij apartamenti: si dhe bashkëjetesës përgjatë periudhës prill 2009 – mars 2015.

### **V/3 Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur**

#### **Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar:**

**1. Apartament banimi 1+1, me sip. 58 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi me bashkëshortin me adresë: Rr. “\*\*\*”, Tiranë,** sipas certifikatës së pronësisë me nr. serie \*\*\*, datë 26.12.2014, vërtetuar sipas kontratës së shitblerjes me kusht dhe rezervë nr. \*\*\*, datë 22.11.2014, nga notere E.A. Vlera 3 000 000 lekë. Pjesa takuese: 50 %.

**Si burim krijimi, subjekti ka deklaruar** kredi bankare në “Raiffeisen Bank” me nr. \*\*\*, datë 9.1.2015, në shumën 2 500 000 lekë dhe huamarrje në shumën 500 000 lekë nga i vëllai, shtetasi E.D. Në lidhje me këtë pasuri subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues.<sup>4</sup>

#### **Komisioni, në lidhje me vërtetimin e fakteve të deklaruara, konstatoi se:**

1.1 Në emër të subjektit të rivlerësimit, znj. Sonila Muhametaj, dhe të personit të lidhur, z. E.M., është e regjistruar pasuria e llojit apartament me sip. 58 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z.k. \*\*\*. Në seksionin e hipotekave është regjistruar shënimi “*bllokohet në favor të Raiffeisen*”

---

<sup>4</sup> Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme (me kusht dhe me rezervë) me nr. \*\*\*, datë 22.11.2014, ku shtetasit E. dhe Sonila Muhametaj si blerës, blejnë apartamentin me sip. 58 m<sup>2</sup>, me adresë: rruga “\*\*\*”, godina \*\*\*, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, në shumën 3 000 000 lekë; certifikatë për vërtetim pronësie datë 10.5.2005, në emër të z. J.J.Z., për apartamentin me sip. 58 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*”, Tiranë; kartelë pronësie në emër të z. J.Z. për apartamentin me sip. 58 m<sup>2</sup>, me shumën e paguar 2 000 000 lekë; kopje e certifikatës familjare, e shtetasit J.Z.; certifikatë personale nr. \*\*\*, datë 20.11.2014, nga Njësia Bashkiake nr. \*\*\*, Tiranë, në emër të shtetasit E.M., bashkëshorti i subjektit; njoftim debitimi në “Raiffeisen Bank” në shumën 500 000 lekë, datë 21.11.2014, me urdhërues znj. Sonila Muhametaj dhe përshkrim “pagesë për blerje apartamenti, në Rr.” \*\*\* dhe shitës J.Z.; kopje të kartave të identitetit të shitësve dhe blerësve; certifikatë për vërtetim pronësie datë 26.12.2014, në emër të shtetasve E. dhe Sonila Muhametaj për apartamentin me sip. 58 m<sup>2</sup>, në Rr. “\*\*\*”, Tiranë; kartelë e pasurisë së paluajtshme në emër të shtetasve E. dhe Sonila Muhametaj, për apartamentin me sip. 58 m<sup>2</sup>, në Rr. “\*\*\*”, Tiranë; pagesë e brendshme në “Raiffeisen Bank”, datë 5.1.2015, në shumën 500 000 lekë, me përshkrimin “likuidim i kështit të parë të çmimit të shitjes sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 22.11.2014”, urdhëruese notere E.A., përfitues L.Z.; njoftim debitimi në “Raiffeisen Bank”, në shumën 2 500 000 lekë, datë 16.1.2015, me përshkrimin “likuidim i çmimit të shitjes sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 22.11.2014, nga shtetasit E. dhe Sonila Muhametaj”, urdhëruese notere E.A., përfitues L.Z.; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 18.12.2015, ku shtetasit J. dhe L.Z. deklarojnë se blerësit E. dhe Sonila Muhametaj kanë likuiduar që në datën 16.1.2015 në total çmimin e shitjes së pasurisë në vlerën 3 000 000 lekë.

*Bank për shumën 2 511 868 lekë*”, konfirmuar me shkresë nga ZVRPP-ja Tiranë<sup>5</sup>. Certifikata e pronësisë në emër të shtetasve E.M. dhe Sonila Muhametaj është lëshuar në datën 26.12.2014.

1.2 Më tej, nga dokumentacioni i administruar nga “Raiffeisen Bank”<sup>6</sup>, konfirmohet kontrata e kredisë bankare nr. \*\*\*, datë 9.1.2015, më kredimarrës E.M. dhe bashkëkredimarrëse Sonila Muhametaj në shumën 2 511 868 lekë, me objekt “blerje shtëpie”, me afat 72 muaj. Në datën 14.1.2015 kredia është disbursuar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe në datën 15.1.2015 shuma 2 500 000 lekë është transferuar te llogaria e noteres, me koment “pagesë për blerje apartamenti ...”.

1.3 **Përveç kredisë subjekti ka deklaruar se ka marrë hua shumën 500 000 lekë nga i vëllai**, shtetasi E.D. dhe i ka bashkëlidhur deklaratës “Vetting” vërtetimin e punësimit të këtij shtetasi dhe lëvizjet e llogarive të tij bankare në “Raiffeisen Bank”, nga ku rezultoi se në datën 20.11.2014 në llogarinë e shtetasit E.D. është kaluar vlera 2 014 323 lekë, si shlyerje nga Fondi Raiffeisen Invest. Me fondet e krijuara nga kjo shlyerje në datën 21.11.2014 është kryer një transfertë te llogaria e subjektit të rivlerësimit në shumën 500 000 lekë me koment “dhënie huaje për blerje apartamenti”. Më pas kjo shumë është transferuar nga llogaria e subjektit të rivlerësimit te llogaria e noteres E.A., person fizik me NIPT \*\*\*, me koment “pagesë për blerje apartamenti ...”

**Komisioni, në lidhje me burimin e krijimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, konstatoi se:**

#### **Për kredinë e marrë gjatë periudhës 2015 – 2016**

1.4 Në lidhje me fillimin e bashkëjetesës me bashkëshortin, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 1, ka deklaruar se bashkëjetesën me shtetasin E.M. e ka filluar në periudhën 2005 – 2006. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëngjitur deklaratës “Vetting” dokumentacion ligjor justifikues për të ardhurat e bashkëshortit<sup>7</sup>.

1.5 Vetëm për të ardhurat e vitit 2016 të subjekti të rivlerësimit kishte mospërputhje midis dokumentacionit të administruar nga “Credins Bank”<sup>8</sup> dhe vërtetimit të datës 12.10.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në lidhje me pagën e muajit janar 2016. Paga për këtë muaj nuk ishte e përfshirë në vërtetimin e lëshuar nga prokuroria dhe për këtë arsye, subjektit iu kërkuan shpjegime me anë të postës elektronike.

1.6 Subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë mospërputhje, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, shpjegoi se: *“Konstatimi juaj mendoj se duhet të jetë një gabim i zyrës së financës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi për periudhën 17.2.2015 deri më 17.2.2016 kam qenë prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Dekret Presidenti). Deklaroj se ky*

<sup>5</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2018.

<sup>6</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.10.2018.

<sup>7</sup> Vërtetim nr. \*\*\*, datë 28.10.2016, nga Ministria e Mbrojtjes, Reparti Ushtarak nr. \*\*\*, për të ardhura, shpërblime dhe ushqime për periudhën 1.5.2010 – 30.9.2014. Shuma totale 2 462 805 lekë; vërtetim të ardhurash nr. \*\*\*, datë 31.10.2016, nga Batalioni i Xhenios për periudhën 1.10.2014 – 31.10.2016, në Repartin Ushtarak nr. \*\*\*. Shuma 1.101.211 lekë; vërtetim të ardhurash nr. \*\*\*, datë 10.1.2017, nga Reparti Ushtarak nr. \*\*\*, për periudhën 1.10.2016 – 31.12.2016. Shuma 135.794 lekë.

<sup>8</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 31.1.2019.

*vërtetim nuk është verifikuar nga ana ime, duke menduar se është një akt i nxjerrë nga Zyra e Financës së Prokurorisë dhe si i tillë duhet të përfshinte pagat për të gjithë periudhën e punësimit tim pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këto kushte, ju vë në dispozicion vërtetimin e pagës neto/bruto për muajin janar 2016 të lëshuar në datën 25.4.2019 nga Zyra e Financës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë”*

### **Hua në shumën 500.000 lekë**

1.7 **Në lidhje me këtë hua marrë nga vëllai i subjektit të rivlerësimit**, shtetasi E.D., subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi të kësaj shume, dhe i ka bashkëngjitur deklaratës “Vetting” vërtetimin e punësimit të këtij shtetasi dhe lëvizjet e llogarive të tij bankare në “Raiffeisen Bank”.

1.8 Nga hetimi u konstatua se personit tjetër të lidhur/huadhënësit në datën 20.11.2014, i ka kaluar në llogari të tij shuma 2 014 323 lekë, si shlyerje nga Fondi Raiffeisen Invest. Subjektit të rivlerësimit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues.

1.9 Nga hetimi u konstatua se investimi në Raiffeisen Invest deri më 28.1.2014 ka qenë në shumën 1 470 000 lekë (investim fillestar në datën 24.9.2013 në shumën 1 000 000 lekë dhe investim më 28.1.2014 në shumën 470 000 lekë).

1.10 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit dorëzoi dokumentacion ligjor justifikues<sup>9</sup>, nga shqyrtimi i të cilit vërehet se shtetasi E.D. ka qenë i punësuar që nga data 28.3.2011, si teknik IT&T pranë “Tirana International Airport”, vërtetuar me dokumentacionin e administruar nga DRT-ja<sup>10</sup> Tiranë dhe ISSH-ja<sup>11</sup>.

1.11 Sipas dokumentacionit të administruar në pikën 1.10, të ardhurat nga paga të shtetasit E.D. për periudhën 2011 – 2013 kanë qenë në shumën 1 169 363 lekë.

1.12 Pra, po të analizojmë të ardhurat e personit tjetër të lidhur, z. E.D., në raport me investimin, rezulton se shuma e investuar (1 470 000 lekë) është 300 637 lekë më shumë se të ardhurat e përfituara nga paga (pa llogaritur shpenzime jetese apo shpenzime të tjera).

1.13 Pavarësisht nga ky analizim i të ardhurave të personit tjetër të lidhur, z. E.D., Komisioni, analizoi mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme në shumën 1 169 363 lekë, dhe konstatoi se personi tjetër i lidhur, z. E.D., ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme në vlerën 500 000 lekë për dhënien e kësaj huaje subjektit të rivlerësimit.

1.14 **Në lidhje me këtë kredi** është kryer analiza financiare nga Njësia e Shërbimit Ligjor pranë Komisionit duke marrë në konsideratë pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur, si dhe personave të tjerë të lidhur.

1.15 Për vitet 2015 dhe 2016, në lidhje me shlyerjen e kësteve të kredisë të marrë në “Raiffeisen Bank”, u krye analiza financiare, duke marrë në konsideratë pasuritë e krijuara, të ardhurat, shpenzimet dhe detyrimet, si më poshtë:

	<b>Përshkrimi</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
--	-------------------	-------------	-------------

<sup>9</sup> Certifikata të trungut familjar të familjes në datat 31.12.2013 dhe 31.12.2014; vërtetim nr. \*\*\*, datë 13.3.2019, nga Tirana Internacional Airport për pagat e vëllait të subjektit të rivlerësimit; vërtetim nr. \*\*\*, datë 13.3.2019, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për të ardhurat në total të shtetasit L.D. me pension familjar dhe pleqërie.

<sup>10</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 2.8.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>11</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 11.7.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.



<b>1</b>	<b>PASURI</b>	<b>3,000,000</b>	<b>0</b>
	Apartament banimi 1+1, 58 m <sup>2</sup>	3,000,000	0
<b>2</b>	<b>DETYRIME</b>	<b>3,011,868</b>	<b>0</b>
	Kredi nga “Raiffeisen Bank”	2,511,868	0
	Hua nga vëllai E.D. <sup>12</sup>	500,000	
<b>3</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>1,810,586</b>	<b>2,065,970</b>
	Të ardhura nga paga subjekti	1,263,182	1,507,404
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	509,721	558,566
	Të ardhura nga vjehrra (për periudhën e bashkëjetesës)	37,683	
<b>4</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>2,142,182</b>	<b>2,246,980</b>
	Shpenzime për shlyerjen e kredive “Raiffeisen Bank”	470,808	491,333
	Shpenzime për shlyerjen e huas ndaj E.D. dhe B.G.	100,000	50,000
	Shpenzime shkollimi për fëmijët	494,852	497,605
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	897,104	940,368
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së (vjehrra sipas periudhës së bashkëjetesës)	56,069	0
	Shpenzime për arredim të shtëpisë Rr. “****”	28,571	200,000
	Shpenzime transferimi vendbanim - vendi i punës	6,600	0
	Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>	48,178	12,174
	Shpenzime automjete <sup>13</sup>	0	15,500
	Shpenzime për pushime brenda vendit	40,000	40,000
<b>5</b>	<b>LIKUIDITETE NË FILLIM TË PERIUdhËS</b>	<b>117,695</b>	<b>-1,122</b>
	Gjendja e llogarive bankare subjekti, b/shorti, e bija	-118,875	-1,122
	Gjendje <i>cash</i>	0	0
	Gjendja e llogarive bankare vjehrra (për periudhën e bashkëjetesës)	236,570	0
<b>6</b>	<b>LIKUIDITETE NË FUND TË PERIUdhËS</b>	<b>99,803</b>	<b>-33,148</b>
	Gjendja e llogarive bankare	-1,122	-33,148
	Gjendje <i>cash</i>		
	Gjendja e llogarive bankare vjehrra (31.03.2015)	100,924	0
	<b>DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 3+2-1-4+5-6)</b>	<b>-301,836</b>	<b>-148,983</b>

1.16 Për sa më lart, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshorti, për shlyerjen e kredisë ka një mungesë të ardhurash në shumën 301 836 lekë për vitin 2015 dhe në shumën 148 983 lekë për vitin 2016 të pajustificuara me dokumentacion ligjor për kryerjen e shpenzimeve për këto dy vite

1.17 Komisioni, nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, i kaloi barrën e provës subjekti të rivlerësimit për një mungesë të ardhurash në shumën prej 301 836 lekësh për vitin 2015 dhe në shumën 148 983 lekë për vitin 2016 të pajustificuara me dokumentacion ligjor për kryerjen e shpenzimeve për këto dy vite.

## 2. Autoveturë, marka “Daimler Crysler”, me targa \*\*\*.

2.1 Në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka në pronësi një autoveturë, në bashkëpronësi me bashkëshortin, e paregjistruar në DPSHTRR-në Tiranë, e vërtetuar sipas lejes së qarkullimit nr. \*\*\*, seri \*\*\*, datë 11.11.2013, në emër të shitësit B.T., marka “Daimler Crysler”, tipi 211 (E220CDI), ngjyrë e zezë, viti i prodhimit 2002, me targa \*\*\*, sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 2.6.2014. Vlera: 4 500 Euro. Pjesa takuese: 50 %.

<sup>12</sup> Hua e marrë në vitin 2014 dhe e përdorur në të njëjtin vit për pagesën e apartamentit, por paraqitur në vitin 2015 edhe tek vlera e apartamentit edhe tek detyrimet.

<sup>13</sup> Vlera e TPL-ve sipas AMF-së.

2.2 **Si burim krijimi subjekti i rivlerësimit ka deklaruar** huamarrjen (borxh) në shumën 1 000 000 lekë, në datën 3.1.2014, shtetasve E. dhe B.G. (me banim dhe shtetësi angleze), motra e subjektit dhe bashkëshorti i saj.

Subjekti në lidhje me këtë deklaram ka bashkëlidhur dokumentacion ligjor justifikues<sup>14</sup>

### **Nga hetimi administrativ i Komisionit rezultoi se:**

2.3 Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë mjete në pronësi, e vërtetuar me përgjigjen nr. \*\*\*, datë 5.7.2017, të DPTSHRR-së, drejtuar ILDKPKI-së.

2.4 Ndërkohë që nga dokumentacioni i administruar me shkresën nr. \*\*\*, datë 28.1.2019, të DPSHTRR-së, konfirmohet se personi i lidhur/E.M. ka në pronësi automjetin me targa \*\*\*, regjistruar në datën 8.6.2017, pra, pas deklaratës “Vetting”.

2.5 Pas verifikimit të kryer në AMF konstatohet se shtetasi E.M. ka qenë përdorues për periudhat 10.10.2013 – 9.10.2014; 5.2.2016 – 4.2.2017; 5.4.2018 – 4.4.2019, ndërsa Sonila Muhametaj ka qenë pronare për periudhën 10.10.2013 – 9.10.2014 dhe përdoruese 1.12.2014 – 30.11.2015; 5.2.2016 – 4.2.2017; 5.2.2017 – 4.2.2018.

2.6 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur kontratë huaje për shumën prej 1 000 000 lekësh të marrë hua nga motra e saj dhe bashkëshorti i motrës, shtetasit E. dhe B.G.

2.7 Për të vërtetuar burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 1 000 000 lekë nga shtetasit E. dhe B.G., subjekti në deklaratën “Vetting” ka bashkëlidhur vetëm kopjen e lejes së qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar, datë 3.2.2016, në emër të E.D. Ky dokumentacion nuk është i mjaftueshëm për të vërtetuar ligjshmërinë dhe mjaftueshmërinë e burimit të krijimit.

2.8 Për këtë arsye, Komisioni, i kërkoi subjektit të rivlerësimit me anë të pyetësorit nr. 2, të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për të provuar mundësitë financiare.

2.9 Në përgjigjen e tij, subjekti i rivlerësimit, ka depozituar kopje të certifikatës që vërteton të ardhurat dhe taksat e paguara në Mbretërinë e Bashkuar për vitin 2013 dhe 2014 nga shtetasi B.G., si edhe kopje të dokumentacionit të përbërjes familjare të shtetasve E. dhe B.G.<sup>15</sup>. Këto dokumente të depozituara nga subjekti nuk ishin në formën e kërkuar nga ligji (të pa noterizuara dhe pa vulë apostile). Për këtë arsye, subjekti në datën 28.05.2015, dorëzoi dokumentacion sipas formës së kërkuar, duke përfshirë edhe certifikatën që vërteton të ardhurat dhe taksat e paguara në Mbretërinë e Bashkuar për vitin 2012 nga shtetasi B.G.

2.10 Pas analizimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, si dhe verifikimit *online* të të ardhurave minimale të jetesës në Mbretërinë e Bashkuar për vitet 2012-2013-2014<sup>16</sup>, rezulton se të ardhurat e përfituara nga shtetasi B.G. janë të mjaftueshme për të dhënë këtë hua në shumën 1 000 000, duke pasur parasysh të ardhurat minimale të nevojshme për një arritur një standard minimal. E gjithë kjo bazuar në analizën e pasqyruara në tabelën më poshtë:

---

<sup>14</sup> Kontratë nr. \*\*\*, datë 2.6.2014, ku shtetasit E. dhe Sonila Muhametaj blejnë autoveturën tip “Daimler Crysler”, në vlerën 4 500 euro; leje qëndrimi \*\*\*, kopje, në emër të znj. E.D.

<sup>15</sup> Certifikatë martese e lëshuar nga autoritetet kompetente të Distriktit të Barnet, Londër, Angli; certifikatë e lindjes së fëmijëve O.G. dhe H.G.

<sup>16</sup> [www.jrf.org.uk/report/minimum-income-standard-uk](http://www.jrf.org.uk/report/minimum-income-standard-uk); faqe nr. 32.

Viti	Të ardhurat <i>bruto</i> të shtetasit B.G.	Të ardhura bruto të nevojshme për të arritur <i>MIS</i> <sup>17</sup> (rasti 1 çift me 2 fëmijë <sup>18</sup> , 1 prind i punësuar)	Diferenca
2012	£ 38 788	£ 34 881	£ 3 907
2013	£ 45 897	£ 36 060	£ 9 837
2014	£ 48 870	£ 37 043	£ 11 827

2.11 Sipas analizës financiare, duket se personat e tjerë të lidhur/huadhënësit, z. B.G. dhe znj. E.G., kanë pasur të ardhura të ligjshme për dhënien e shumës 1 000 000 lekë, në vitin 2014.

2.12 Subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore ka deklaruar se:

- shumën 750 000 lekë e ka shlyer në vitin 2014;
- shumën 100 000 lekë e ka shlyer në vitin 2015; si dhe
- shumën 50 000 lekë e ka shlyer në vitin 2016.

2.13 **Për të analizuar mundësitë financiare për shlyerjen e kësaj huaje për vitet 2014 - 2015 – 2016**, Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, nga e cila rezultoi se ka mungesë të ardhurash nga burime të ligjshme për vitin 2014 (siç janë paraqitur në tabelën më poshtë), si edhe për vitin 2015 dhe 2016 (të paraqitur në pikën 1.15)

	Përshkrimi	2014
<b>1</b>	<b>PASURI</b>	<b>630,495</b>
	Autoveturë marka “Daimler Chrysler”, targa ****	630,495
<b>2</b>	<b>DETYRIME</b>	<b>1,000,000</b>
	Hua nga e motra dhe bashkëshortit të saj, E. dhe B.G.	1,000,000
<b>3</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>1,731,723</b>
	Të ardhura nga paga subjekti	1,089,946
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	539,958
	Të ardhura nga vjehrra (për periudhën e bashkëjetesës)	101,819
<b>4</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>2,334,118</b>
	Shpenzime për shlyerjen e kredive “Raiffeisen Bank”	368,741
	Shpenzime për shlyerjen e huas ndaj E.D. dhe B.G.	750,000
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	879,992
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së (vjehrra sipas periudhës së bashkëjetesës)	146,665
	Shpenzime për arredim të shtëpisë Rr. “****”	28,571
	Shpenzime qiraje	40,000
	Shpenzime transferimi vendbanim – vendi i punës	52,800
	Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>	10,368
	Shpenzime automjete	16,980
	Shpenzime për pushime brenda vendit	40,000
<b>5</b>	<b>LIKUIDITETE NË FILLIM TË PERIUDHËS</b>	<b>77,280</b>
	Gjendja e llogarive bankare subjekti, bashkëshorti, e bija	-118,125
	Gjendja <i>cash</i>	0
	Gjendja e llogarive bankare vjehrra (për periudhën e bashkëjetesës)	195,405

<sup>17</sup> Minimum *income standart* (standardi i të ardhurave minimale).

<sup>18</sup> Fëmija i dytë ka lindur në gusht të vitit 2013.

<b>6</b>	<b>LIKUIDITETE NË FUND TË PERIUDHËS</b>	<b>117,695</b>
	Gjendja e llogarive bankare subjekti, bashkëshorti, e bija	-118,875
	Gjendje <i>cash</i>	0
	Gjendja e llogarive bankare vjehrra (për periudhën e bashkëjetesës)	236,570
	<b>DIFERENCA (TË ARDHURA –PASURI –SHPENZIME 3+2-1-4+5-6)</b>	<b>-273,305</b>

1.18 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me provat e administruara gjatë hetimit administrativ.

1.19 Në lidhje me analizimin e burimit të ligjshëm, Komisioni, nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, i kaloi barrën e provës subjekti të rivlerësimit për një mungesë të ardhurash të ligjshme në vlerën 273 305 lekë për vitin 2014 të pajustificuara me dokumentacion ligjor, për kryerjen e shpenzimeve për këtë vit.

### **3. Autoveturë, tip “Audi A4”, viti i prodhimit 1996**

3.1 Në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka në përdorim autoveturë, tip “Audi A4”, në bashkëpërdorim me bashkëshortin, e paregjistruar në DPSHTRR-në Tiranë, e vërtetuar sipas lejes së qarkullimit nr. \*\*\*, datë 21.9.2006, me targa \*\*\*, viti i prodhimit 1996, me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 22.12.2008, me vlerë 600 000 lekë. Pjesa takuese: 50 %.

3.2 **Si burim krijimi ka deklaruar** shumën 500.000 lekë të përfituar nga shitja e autoveturës tip “Mercedes Benz 250D”, datë 9.1.2009 (kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 28.2.2009), dhe 100.000 lekë të ardhura personale.

Në lidhje me këtë pasuri subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion ligjor justifikues<sup>19</sup>.

#### **Nga hetimi administrativ i Komisionit rezultoi se:**

3.3 Çmimi i shitjes sipas kontratës është në vlerën 650 000 lekë dhe jo 600 000 lekë, siç është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, kontrata e shitjes së automjetit tip “Mercedes - Benz”, shitja e të cilit ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip “Audi A4”, është lidhur 2 muaj më vonë.

3.4 Për sa më lart, në pyetësorin nr. 3, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit, e cili sqaron se: *“Lidhur me çmimin e automjetit ju deklaroj me përgjegjësi se është një gabim material nga ana ime, si rrjedhojë, edhe shuma e të ardhurave personale. Ju deklaroj gjithashtu se burimi i të ardhurave për automjetin ‘Audi A4’ janë pikërisht të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit ‘Mercedes-Benz’ dhe të ardhurat personale (të miat dhe të bashkëshortit E.M., në atë kohë bashkëjetues). Mospërputhja lidhur me veprimet juridike të kryera ka të bëjë me faktin se bashkëshorti im, z. E.M., ka pasur marrëdhënie mirëbesimi me blerësin e automjetit ‘Mercedes-Benz’ shtetasin M.Xh., sepse kanë punuar së bashku në të njëjtin Repart Ushatark nr. \*\*\*, Vacarr, Tiranë. Për shkak të kësaj marrëdhënie mirëbesimi automjeti ‘Mercedes Benz’ i është dhënë fizikisht, kundrejt parave, blerësit M.Xh. pikërisht ditën e blerjes së automjetit Audi A4, për të cilin është lidhur kontrata e shitblerjes dhe i janë*

<sup>19</sup> Kontratë shitblerje automjeti nr. \*\*\*, datë 22.12.2008, ku z. E.M. blen autoveturën tip “Audi A4”, në shumën 650 000 lekë; kontratë shitblerje automjeti nr. \*\*\*, datë 28.1.2009, ku shitësi E.M. shet automjetin tip “Mercedes Benz”, në shumën 500 000 lekë.

*dhënë paratë shitësit E.R. Ndërsa formalizimi i veprimit juridik me kontrate shitblerje për automjetin 'Mercedes-Benz' është bërë pak më vonë, thjesht për shkak neglizhence të palëve (afro një muaj)”*

3.5 DPSHTRR-ja, në përgjigjen e saj, me shkresën nr. \*\*\*, drejtuar ILDKPKI-së në datën 5.7.2017, konfirmon se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë mjete në pronësi.

3.6 DPSHTRR-ja, m shkresën nr. \*\*\*, datë 28.1.2019, drejtuar Komisionit, konfirmon se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë në pronësi vetëm mjetin me targa \*\*\*.

3.7 Në pyetësin nr. 2, subjekti i rivlerësimit është pyetur në lidhje me arsyet e këtij mosregjistrimi dhe në përgjigje ai ka deklaruar se: *“Shprehja e paregjistruar ka të bëjë me faktin se nuk është ndryshuar emri i pronarit të parë E.R. në emrin e pronarit të ri E.M., sipas kontratës së shitblerjes së automjetit, në DRSHTRR-në Fier. Nga ana juridike dhe faktike ky automjet ka qenë send personal i ish-bashkëjetuesit tim E.M., por i përdorur për nevoja të bashkëjetesës familjare dhe familjes së tij të origjinës. Duke qenë send personal i ish-bashkëjetuesit tim, detyrimi ligjor e moral në lidhje me këtë automjet (si dokumentacioni ligjor apo mirëmbajtja fizike) i ka takuar atij, përfshirë këtu edhe ndarjen e punëve dhe detyrimeve të bashkëjetesës. Por, me aq sa mbaj mend, ky automjet ka pasur probleme teknike të mëdha, nuk është përdorur shumë dhe kjo është arsyeja e mosregjistrimit në DRSHTRR, e deklaruar nga bashkëshorti im, madje duke e justifikuar gjendjen teknike të mjetit me anë të një preventivi paraprak të lëshuar nga \*\*\* sh.p.k., ku vlera e rregullimit të mjetit shkonte sa gjysma e çmimit të blerjes dhe pagimi i kësaj shume parash për rregullimin e mjetit nuk ishte në interesin tonë familjar. Ky automjet është çregjistruar në DRSHTRR-në Fier”.*

3.8 Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar shkresën e Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të transportit të Transportit Rrugor Fier<sup>20</sup>, ku konfirmohet se mjeti me targa \*\*\* është çregjistruar përgjithmonë në bazë të ligjit të faljes nr. \*\*\*, si edhe preventivin e lëshuar nga “\*\*\*\*” sh.p.k., me vlerë 350 250 lekë.

3.9 Nga kërkimi në AMF për automjetin me targa \*\*\* konstatohet se shtetasit E.M. dhe Sonila Muhametaj kanë qenë përdorues për periudhat 2.11.2009 – 01.11.2010 dhe 4.11.2011 – 3.11.2012.

3.10 Në lidhje me çmimin e shitjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, Komisioni konstatoi se çmimi i shitjes është dyfishi i çmimit të blerjes (blerë 250 000 lekë dhe shitur 500 000 lekë).

3.11 Nga kërkimi në AMF për automjetin me targa \*\*\* konstatohet se shtetasi E.M. ka qenë përdorues për periudhat 5.4.2008 – 4.4.2009 dhe 7.5.2009 – 6.5.2010, ndërkohë që kontrata e shitjes mban datën 28.2.2009.

3.12 Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2006, ka deklaruar se ka në pronësi një automjet tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 1988, në bashkëpronësi me E.M., me vlerën 250 000 lekë. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka gjendje *cash* në vlerën 250 000 lekë për ta përdorur për riparimin e automjetit. Kjo konfirmohet edhe në pyetësin nr. 6, ku subjekti i rivlerësimit shpjegon se: *“Është fakt që unë dhe bashkëjetuesi im kemi marrë kredi në “Raiffeisen Bank” në vitin 2006 në shumën 500 000 lekë. Kjo shumë është përdorur nga ne për blerjen e automjetit tip ‘Mercedes-Benz’ në vlerën 250 000 lekë dhe*

---

<sup>20</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 15.3.2019.

*pjesa tjetër e kredisë po në shumën 250 000 lekë është përdorur e gjitha për riparimin e saj. Shpenzimi për riparimin e automjetit është kryer menjëherë pas marrjes së mjetit në dorëzim dhe brenda vitit të blerjes (2006)”*

3.13 Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur.

3.14 Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëngjitur deklaratën “Vetting” dokumentacion ligjor justifikues<sup>21</sup> për të ardhurat nga pagat si prokurore; të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës; dhe të ardhurat nga ISSH-ja për barrë lindje.

3.15 Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar që bashkëjetesën me shtetasin E.M. e ka filluar në periudhën 2005–2006.

3.16 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me të ardhurat nga pagat e bashkëshortit për periudhën 1.9.2002–1.5.2010, pranë Repartit Ushtarak nr. \*\*\*, në deklaratën “Vetting” nuk e specifikon vlerën e këtyre të ardhurave, por deklaroi se: *“Paga shtetërore e bashkëshortit si Oficer Kapiten në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Reparti Ushtarak nr. \*\*\* (fillimi i detyrës 1.9.2002 – 1.5.2010), nuk është vënë në dispozicion nga punëdhënësi, MB dhe as nga ISSH-ja, megjithë kërkesat e bëra zyrtarisht. Gjithsesi, mund t’iu referohuni edhe statement bankare”.*

Subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues<sup>22</sup> për këto deklarime.

3.17 Komisioni hetoi në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për periudhën 1.5.2015 – 2006, duke kërkuar informacion nga “Raiffeisen Bank”, Ministria e Mbrojtjes dhe Degës e Arkivit Qendror të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (Lundër).

3.18 Nga hetimi administrativ u konstatua se të ardhurat nga paga kanë qenë:

Përshkrim	2006	2007	2008	2009	2010
Transferuar në “Raiffeisen Bank” me koment "paga" ose "shpërblime"	348,473	396,055	392,925	437,674	186,696
Deklaruar në deklaratën vjetore të interesave periodike	nuk ka deklarim nga b/shorti	415,431	505,953	0	0
Konfirmuar nga Dega e Arkivit Tiranë	299,832	290,139	382,658	427,002	149,226

<sup>21</sup> Vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, shuma 6 096 886 lekë; vërtetim nr. \*\*\*, datë 21.10.2016 dhe nr. \*\*\*, datë 21.10.2016, nga ISSH-ja, shuma 583 164 lekë dhe 509 573 lekë; vërtetim datë 12.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; vërtetim nr. \*\*\*, datë 16.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, shuma 1 336 807 lekë; vërtetim nr. \*\*\*, datë 18.10.2016, nga Shkolla e Magjistraturës, shuma 952 290 lekë.

<sup>22</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot, datë 24.3.2011, të ish-Repartit Ushtarak nr. \*\*\*, në lidhje me dorëzimin e listpagesave në DRSSH-në Tiranë, plus praktika; kthim përgjigje nr. \*\*\*, datë 27.1.2017, nga DRSSH-ja Tiranë për vërtetimin nr. \*\*\*, datë 27.1.2017, vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të z. E.M. në periudhat tetor 2002 – shkurt 2005, janar 2007 – prill 2010; shkresë nr. \*\*\* prot, datë 24.10.2016, nga Komanda e Forcës Tokësore ku konfirmohet se në Arshivën e Repartit Ushtarak nr. \*\*\* nuk disponohen listpagesa për repartet dhe periudhat ku ka punuar kapiten E.M.; kërkesë e znj. Sonila Muhametaj drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, Komandës së Forcës Tokësore dhe Komandës Mbështetëse për vërtetim mbi pagën neto dhe bruto të bashkëshortit, E.M., për periudhën nga 1.9.2002 (fillim i detyrës) e aktualisht; kërkesë e znj. Sonila Muhametaj drejtuar DRSSH-së Tiranë për vërtetim mbi pagën neto dhe bruto të bashkëshortit, E.M., për periudhën 1.9.2002 – 31.12.2009; *statement* llogarie nga “Raiffeisen Bank”, datë 17.10.2016, për llogari page të z. E.M. për periudhën 3.6.2005 – 3.10.2016, ku figurojnë kreditimet e pagave; *statement* llogarie nga “Credins Bank”, datë 17.10.2016, për llogari page të z. E.M. për periudhën 30.3.2011 – 2.11.2015, ku figurojnë kreditimet e pagave.

3.19 Në përgjigjen<sup>23</sup> e dërguar nga Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë (Lundër) mungonin të dhëna për disa muaj, ndërsa Ministria e Mbrojtjes nuk iu përgjigj shkresës<sup>24</sup> së dërguar nga Komisioni.

3.20 Në analizën financiare të kryer nga Komisioni u morën në konsideratë të ardhurat nga paga të reflektuara në lëvizjet e llogarive bankare në “Raiffeisen Bank”, analizë e cila pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

	<b>Përshkrimi</b>	<b>2008</b>
<b>1</b>	<b>PASURI</b>	<b>650,000</b>
	Autoveturë “Audi A4”, targa ***, blerë në datën <b>22.12.2008</b>	650,000
<b>2</b>	<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>
<b>3</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>1,761,441</b>
	Të ardhura nga paga subjekti	860,394
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	392,925
	Të ardhura nga interesat në depozita bankare	8,122
	Të ardhura nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, targa ***	500,000
<b>4</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>500,148</b>
	Shpenzime për shlyerjen e kredive “Raiffeisen Bank”	72,556
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	273,240
	Shpenzime për arredim të shtëpisë Rr. “***”	25,000
	Shpenzime transferimi vendbanim - vendi i punës	26,400
	Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>	59,128
	Shpenzime automjete	13,824
	Shpenzime për pushime brenda vendit	30,000
<b>5</b>	<b>LIKUIDITETE NË FILLIM TË PERIUDHËS</b>	<b>438,807</b>
	Gjendja e llogarive bankare	38,807
	Gjendje <i>cash</i>	400,000
<b>6</b>	<b>LIKUIDITETE NË FUND TË PERIUDHËS</b>	<b>601,993</b>
	Gjendja e llogarive bankare	1,993
	Gjendje <i>cash</i>	600,000
	<b>DIFERENCA (TË ARDHURA - PASURI-SHPENZIME 3+2-1-4+5-6)</b>	<b>448,107</b>

3.21 Komisioni, nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, arrin në konkluzionin se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar për sa i përket mosregjistrimit të automjetit dhe subjekti i rivlerësimit bashkë me personin e lidhur/bashkëshortin, kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e pasurisë, si dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2008.

#### **4. Overdraft , në vlerën 5 500 lekë, në “Raiffeisen Bank”**

4.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *overdraft*, në vlerën 5 500 lekë, në “Raiffeisen Bank”

4.2 Me shkresën nr. \*\*\*, datë 19.10.2018, “Raiffeisen Bank” konfirmon se gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 është -7 095 lekë.

<sup>23</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.5.2019.

<sup>24</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.3.2019.

4.3 Komisioni konstaton se llogaria nr. \*\*\* është llogari page. Kreditimet në këtë llogari vijnë nga pagat dhe shpërblimet, si edhe depozitime nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

4.4 Komisioni, nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, arrin në konkluzionin se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar.

#### **5. Depozitë llogari rrjedhëse me nr. \*\*\*, në shumën 565 lekë, në “Credins Bank”**

5.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitë llogari rrjedhëse me nr. \*\*\*, në shumën 565 lekë, në “Credins Bank”.

5.2 Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëngjitur deklaratës “Vetting” dokumentacion ligjor justifikues<sup>25</sup>.

5.3 Me shkresën nr. \*\*\*, datë 31.1.2019, “Credins Bank” konfirmon balancën 565 lekë në datën 31.12.2016.

5.4 Komisioni konstaton se kreditimet në këtë llogari vijnë nga transferime nga llogaria e pagës, si edhe depozitime nga subjekti i rivlerësimit.

5.5 Komisioni, nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, arrin në konkluzionin se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar.

#### **6. Depozitë në emër të vajzës A.M., akorduar nga Bashkia Tiranë (bonus lindje fëmije), në shumën 5 000 lekë**

6.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitë në emër të vajzës A.M., akorduar nga Bashkia Tiranë (bonus lindje fëmije), në shumën 5 000 lekë.

6.2 Me shkresën nr. \*\*\*, datë 19.10.2018, “Raiffeisen Bank” konfirmon se në llogarinë nr. \*\*\*, datë 22.1.2010, në emër të A.M. është transferuar shuma 5 000 lekë me koment “Bonus Bashkia Tiranë”

6.3 Komisioni, nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, arrin në konkluzionin se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar.

### **KONSTATIME TË TJERA GJATË HETIMIT**

#### **7. Apartament me sip. 73.1 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, blerë në datën 13.7.2010, në pronësi të së ndjerës, personit tjetër të lidhur/znj. B.M.**

7.1 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni konstatoi që subjekti i rivlerësimit rezultonte bashkëkredimarrëse në një kredi në “Raiffeisen Bank” në datën 13.9.2010, me objekt: “kredi konsumatore me hipotekë”, në vlerën 1 365 000 lekë, me afat 180 muaj, me kredimarrës E.M. dhe hipotekuese znj. B.M.

7.2 Në pyetësin nr. 2, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të shpjegojë përdorimin e fondeve të disbursuara nga kjo kredi, e cila shpjegoi se: “Destinacioni i shumës së disbursuar të kredisë ka qenë për rikonstrukcion dhe blerje të apartamentit 2+1, sip. 73.1 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z.k. \*\*\*, me adresë: Rr. “ \*\*\*\*”, p. \*\*\*, sh. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, të vjehrrës shtetases B.M.

<sup>25</sup> Statement llogarie datë 25.1.2017 nga “Credins Bank”, me balancë datë 25.1.2017, në shumën 565 lekë.



(kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 13.7.2010, të noteres M.Sh.). Konkretisht, shuma e dhënë nga kjo kredi nga bashkëshorti E.M. për blerje të banesës, për llogari të nënës së tij B.M., ka qenë 400 000 lekë, vërtetuar me deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., datë 20.9.2010, të noteres M.Sh., ndërsa pjesa e mbetur e kredisë është shpenzuar e gjitha për rikonstruksionin e banesës.... Theksoj se burimi i pasurisë për blerjen e kësaj prone nga vjehrra ime janë të ardhurat e fituara nga shitja e banesës 1+1 (pronë e saj që në vitin 2001), kursimeve të saj familjare dhe shumës 400,000 lekë nga kjo kredi”. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar dokumentacion justifikues ligjor<sup>26</sup> për këtë apartament.

7.3 Sipas deklarimit të subjektit të rivlerësimit në pyetësin nr. 2, ky është apartamenti ku subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e saj kanë jetuar deri në vitin 2015, me pak shpërndarje.

7.4 Komisioni konstaton se ky apartament i është blerë në datën 13.7.2010, shitësve N. dhe B.M., me blerës znj. B.M., me çmim 4 459 100 lekë. Në kontratën e shitblerjes<sup>27</sup> citohet se: “Kjo vlerë është likuiduar në “Raiffeisen Bank” në nr. e llogarisë së z. E.M. me nr. \*\*\*. Shitësit deklarojnë se kanë marrë në dorëzim vlerën e mësipërme dhe nuk kanë dhe nuk do të kenë si tani dhe në të ardhmen asnjë lloj pretendimi lidhur me të”.Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësit nr. 3, ka dorëzuar një vërtetim nga “Raiffeisen Bank”<sup>28</sup>, ku konfirmohet së në datën 26.7.2010 është bërë transferimi i shumës 4 100 000 lekë nga llogaria e shtetasit B.M. te llogaria e shtetasit E.M. me nr. \*\*\*, me përshkrimin “pagesë për blerje apartamenti”.

7.5 Komisioni, në lidhje me tri burimet e krijimit të kësaj pasurie, konstaton se:

**Burimi nr. 1:** shuma 3 269 600 lekë të ardhura nga shitja e apartamentit 1+1, me sip. 53.6 m<sup>2</sup>.

7.6 Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti ky apartament është blerë në datën 16.6.2001 në shumën 1 950 000 lekë. Sipas deklarimit të subjektit të rivlerësimit në pyetësin nr. 2, në kohën e blerjes së këtij apartamenti, subjekti i rivlerësimit nuk njihej me të ndjerën.

7.7 Ky apartament është shitur në datën 13.7.2010 në shumën 3 269 600 lekë. Sipas deklarimit të subjektit të rivlerësimit në pyetësin nr. 2, në këtë apartament ka jetuar subjekti i rivlerësimit pas martesës në vitin 2009.

**Burimi nr. 2:** shuma 400 000 lekë dhënë nga z. E.M. nënës së tij, të ndjerës B.M.

7.8 Në deklaratën noteriale të datës 20.9.2010, të dorëzuar nga subjekti, shtetasi E.M. deklaroi se ka likuiduar shumën 400 000 lekë në favor të shitësve dhe se znj. B.M. iu ka më shitësve detyrim për këtë shumë.

7.9 Komisioni konstaton se kjo shumë është transferuar nga llogaria e z. E.M. te llogaria e z. E.M. në “Raiffeisen Bank (përfaqësues me prokurë i shitësve të apartamentit) në datën 20.9.2010.

---

<sup>26</sup> Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 16.6.2001, të noteres R.S., për apartamentin 1+1, me sip. 53.6 m<sup>2</sup>, ku palë blerëse figuron B.M.; kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 12.7.2010, të noteres M.Sh., për apartamentin 1+1, me sip. 53.6 m<sup>2</sup>, ku figuron palë shitëse B.M.; kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 13.7.2010, të noteres M.Sh., për apartamentin 2+1, me sip. 73.1 m<sup>2</sup>, ku figuron palë blerëse B.M.; deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., datë 20.9.2010, të noteres M.Sh.

<sup>27</sup> Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 13.7.2010, të noteres M.Sh.

<sup>28</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.6.2019, lënda “kthim përgjigje”, drejtuar subjektit të rivlerësimit.

**Burimi nr. 3:** të ardhura nga kursimet familjare të znj. B.M. të cilat rezultojnë të jenë në shumën 789 500 lekë (4 459,100 – 3 269 600 – 400 000 = 789 500 lekë).

7.10 Në pyetësin nr. 6, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime dhe dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me mundësinë financiare të znj. B.M. për të kursyer shumën 789 500 lekë.

7.11 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se: *“E kam shumë të vështirë t’i përgjigjem kësaj pyetje, sepse vjehrra ime ka ndërruar jetë (më 27.10.2018), dhe do të ishte shumë e nevojshme për nevoja të këtij procesi të më orientonte apo të më shpjegonte edhe mua si subjekt kursimet e saj të fituara prej afro 35 vjet punë”.*

7.12 Më tej, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se referuar dokumentacionit të punësimit, si dhe shpjegimeve të marra nga të tre fëmijët e saj, gjendja financiare e të ndjerës në total përbëhej nga të ardhurat e fituara prej saj dhe bashkëshortit, të birit, të dy vajzave, si dhe nga siguracioni i dëmshpërblimit për jetën e bashkëshortit të saj të ndjerit S.M. (vdekur për shkak aksidenti automobilistik më 17.3.2000), konkretisht:

- i. të ardhurat e të ndjerës dhe të bashkëshortit të saj të ndjerë, të cilat i kanë pasur gjendje para vitit 2001 (periudha në të cilën kanë blerë banesën në Tiranë) ku bashkëshorti i saj i ndjerë S.M. ka punuar në Parkun e Transnaftës në Patos, Fier, me detyrë shofer, ndërsa vetë e ndjera ka punuar si teknologe naftë;
- ii. të ardhurat e përfituara nga pensioni familjar dhe i pleqërisë së znj. B.M. (periudha 2001 – 2018);
- iii. të ardhurat e realizuara nga puna në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë për periudhën 2001 – 2010.
- iv. të ardhurat e të birit E.M. nga viti 2001 deri më 2006, realizuar nga puna si oficer në Forcat e Armatosura.
- v. dëmshpërblimi për jetën e bashkëshortit, z. S.M., për shkak të humbjes së jetës nga një aksident automobilistik;
- vi. të ardhurat e realizuara nga puna private e pasiguar e të ndjerës dhe të birit, e kryer jashtë orarit zyrtar.
- vii. të ardhurat e realizuara nga E.M. si trupprojë, në oraret e vona të natës apo edhe në fundjavë në lokale dhe hotele të ndryshme të Tiranës dhe të Durrësit dhe konkretisht, ish-Hotel Sheraton, Tropikal Durrës, Venue, dhe disko San Paolo.
- viii. të ardhurat e realizuara nga puna artizanale e të ndjerës;
- ix. të ardhurat e realizuara nga dy vajzat e saj nga puna në furrë buke apo në pastrim kimik gjatë kohës që vazhdonin shkollën e mesme;

7.13 të ardhura të fituara nga punësimet e të dy vajzave A. dhe O.M. menjëherë pas mbarimit të shkollës së mesme dhe gjatë gjithë kohës kur kanë qenë studente në Fakultetin e Veterinarisë dhe atë të Drejtësisë, nga viti 2002-2006 dhe në vazhdim të cilat për shkak të informalitetit në vendin tonë asnjëherë nuk u janë paguar sigurimet shoqërore nga punëdhënësit e tyre. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar dokumentacion justifikues ligjor nga “Intesa Sanpaolo Bank”. Në datën 24.11.2006 është kryer një depozitim me vlerë 600 000 lekë dhe është çelur një depozitë bankare me datë maturimi 8.4.2010. Në datën 8.4.2009, përpara afatit të maturimit, është kryer tërheqje në shumën 300 000 lekë, pa përshkrim, dhe në datën 17.9.2009 një tërheqje me vlerë

367 395,7 lekë me përshkrim “dasma e vajzës”. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se depozita është tërhequr para kohës së blerjes së apartamentit.

7.14 Në tabelën e mëposhtme paraqiten në mënyrë të përmbledhur të ardhurat nga burimet e ligjshme.

Përshkrim	Vlerë
Të ardhura nga shitja e apartamentit me sip. 53.6 m <sup>2</sup>	3,269,600
Pagesë nga E.M. nga kredia e marrë në “Raiffeisen Bank”	400,000
Kursime familjare (tërheqje nga Intesa Sanpaolo Bank)	300,000
Vlera e apartamentit me sip. 73.1 m <sup>2</sup>	- 4,459,100
<b>Diferenca</b>	<b>- 489,500</b>

7.15 Për të justifikuar kursimet e të ndjerës B.M., subjekti i rivlerësimit dorëzoi dokumentacion ligjor justifikues për të ardhurat nga punësimi dhe nga pensioni familjar i saj<sup>29</sup>. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se në përlogaritjen e konsumit jetik duhet të mbahet parasysh dhe fakti që shtetasja B.M. dhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. E.M., janë trajtuar me statusin e ushtarakut dhe kanë përfituar trajtim ushqimor dhe veshmbathje sipas gradës së ushtarakut.

Për periudhën 2001 – qershor 2010, të ardhurat e ligjshme kanë qenë në shumën 2 818 622 lekë<sup>30</sup>; shpenzimet jetike në shumën 3 325 653 lekë<sup>31</sup>; gjendje likuiditete në llogaritë bankare në shumën 136 077 lekë, duke rezultuar në një diferencë negative prej 643.108 lekësh. Në analizë nuk janë përfshirë: kursime gjendje *cash* të znj. B.M. dhe të z. S.M. përpara vitit 2001; të ardhurat nga pagat e bashkëshortit të subjektit, z. E.M., për periudhën 2001– maj 2005, për shkak të mungesës së të dhënave; dëmshtëpërblimi për jetën e bashkëshortit S.M., për shkak të humbjes së jetës nga një aksident automobilistik<sup>32</sup>; si dhe të ardhurat e realizuara ndër vite nga puna private e të ndjerës, të birit dhe të dy vajzave, për shkak të mungesës së dokumentacionit ligjor justifikues.

7.16 Në lidhje me analizimin e burimit të ligjshëm nga gjendja *cash* e personit tjetër të lidhur, vjehrrës së subjektit të rivlerësimit, që ka shërbyer për blerjen e apartamentit, Komisioni nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, i kaloi barrën e provës subjekti të rivlerësimit për një mungesë të ardhurash të ligjshme prej 489 500 lekësh të pajustificuara me dokumentacion ligjor për kryerjen e shpenzimeve për këto dy vite.

#### **V/4 Prapësimet e subjektit, për sa më lart, në përgjigje të barrës së provës dhe gjatë seancës dëgjimore, konstatuar nga hetimet**

##### **Lidhur me mungesën e të ardhurave të ligjshme për vitet 2006 – 2016**

<sup>29</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 10.7.2019, të ISSH-së (pension familjar); vërtetim Agjencia e Punësimit Patos për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare; vërtetim Reparti Ushtarak nr. \*\*\* për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare; vërtetim Reparti Ushtarak nr. \*\*\* për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 21.3.2017, Reparti Ushtarak nr. \*\*\* për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare (pagesë kalimtare).

<sup>30</sup> Të ardhurat nga pagat, pensioni familjar dhe ai i pleqërisë B.M. (2001 – qershor 2010), në shumën 2 552 202 lekë dhe të ardhura nga pagat E.M. (qershor - dhjetor 2005), në shumën 266 420 lekë.

<sup>31</sup> Periudha 2001–2005: 4 persona; 2006 – 2007: 3 persona; 2008: 2 persona; 2009 – qershor 2010: 1 person.

<sup>32</sup> Në pyetësorin nr. 6, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 22.5.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku vërtetohet fakti i vdekjes si rezultat i aksidentit të shtetasit S.M., në datë 17.3.2000.

1. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, shpjegon se në analizën financiare të Komisionit janë marrë parasysh gjendjet monetare në bankë dhe *cash*, pavarësisht se rezultojnë likuide në teprica monetare pozitive ndër vite (2006 – 2011, në shumën totale 3 744 599 lekë). Sipas subjektit, formularët e deklarimit të interesave pasurorë nuk duhet të merren për bazë për të provuar ligjshmërinë e burimeve financiare, pasi ato duhet të provohen me dokumentacion ligjor dhe jo në deklarata. Bazuar në këtë përlllogaritje, subjekti pretendon që për të gjithë periudhën 2006 – 2016 ka pasur tepricë monetare në vlerë pozitive dhe në asnjë vit financiar nuk rezulton negative.
2. Reduktimi i shpenzimeve jetike për fëmijët për vitet 2015 - 2016. Subjekti pretendon që kostoja e jetesës për të dy fëmijët e mitur nuk duhet të llogaritet e plotë, pasi vakti i mëngjesit dhe i drekës, si dhe veshja e shkollës së vajzës kanë qenë të paguara brenda shpenzimeve për edukimin e tyre (vajza ka ndjekur shkollën “\*\*\*\*”, ndërsa djali ka qenë në çerdhe dhe kopsht shtetëror).
3. Reduktimi i shpenzimeve jetike për bashkëshortin e subjektit për vitet 2015 - 2016. Subjekti pretendon që për shkak të statusit të ushtarakut bashkëshorti është trajtuar me vlerë ushqimore në vlerën 2 000 lekë/muaj.
4. Reduktimi i shpenzimeve jetike të vjehrrës së subjektit për vitin 2014 dhe për muajin mars të vitit 2015. Subjekti shpjegon se vjehrra e saj ka pasur statusin e pensionistes para kohe dhe pasqyrimi i të ardhurave dhe shpenzimeve ndikon negativisht në analizën financiare. Lidhur me vitin 2015, subjekti pretendon që ka jetuar me vjehrrën vetëm në janar – shkurt, pasi më 1 mars ka dalë në banesën e saj aktuale.
5. Reduktimi në zero i shpenzimeve të arredimit për vitet 2014 dhe 2015. Subjekti shpjegon se në vitin 2014 nuk ka kryer asnjë shpenzim dhe ka deklaruar se në vitin 2015 nuk ka kryer asnjë shpenzim arredimi.
6. Reduktimi në zero i shpenzimeve *TIMS* për vitet 2015 - 2016. Lidhur me vitin 2015, subjekti pretendon zerim të shpenzimeve *TIMS*, pasi bashkëshorti ka qëndruar te të afërmit e tij në Greqi, të cilët kanë marrë përsipër të gjitha shpenzimet. Arsyeja e vizitës ka qenë dasma e kushërirës. Ndërsa, lidhur me vitin 2016, subjekti pretendon zerim të shpenzimeve *TIMS*, pasi bashkëshorti ka hyrje-dalje brenda ditës me të motrën, shtetasen A.B. Destinacioni ka qenë në Kosovë, qëllimi i vizitës ka qenë për arsye familjare të motrës dhe shpenzimet e udhëtimit janë marrë përsipër nga ajo.
7. Reduktimi në zero i shpenzimeve për pushime brenda vendit për vitet 2014 - 2015 - 2016. Subjekti deklaron që pushimet kanë qenë tepër modeste me ushqim me vete, vajtje-ardhje.
8. Reduktimi i shpenzimeve të transportit për në vendin e punës. Subjekti pretendon që shpenzimi vjetor ka qenë më pak se 52 800 lekë, për shkak të pushimeve të festave zyrtare, ditëve me raport shëndetësor të fëmijëve, apo udhëtimeve të herëpashershme me kolegët.
9. Reduktimi në zero i shpenzimeve *TIMS* për vitin 2014. Subjekti pretendon që bashkëshorti ka qenë për një vizitë njëditore për turizëm në Ulqin dhe në total ka shpenzuar 3 700 lekë.
10. Reduktim i shpenzimeve të qirasë për vitin 2014. Subjekti pretendon që ka jetuar me qira deri në mars të vitit 2014 dhe në prill është rikthyer në banesën e vjehrrës.

## **Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme të gjendjes *cash* nga personi tjetër i lidhur/vjehrrës së subjektit të rivlerësimit, për shumën 489 500 lekë**

11. Subjekti pretendon se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë shumën prej 367 395 lekësh, të tërhequr nga e ndjera znj. B.M., në datën 17.9.2009 (me koment “dasma e vajzës). Subjekti shpjegon se vajza për të cilën janë tërhequr paratë, shtetasja O.Z., ia ka marrë nënës së saj shumën 400 000 lekë, me qëllim mbulimin e shpenzimeve të dasmës (datë 26.9.2009) dhe pas përfundimit të dasmës ia ka rikthyer të gjitha njëherësh.

12. Subjekti shpjegon se për periudhën 1.1.2012 – 18.6.2012 shpenzimet kanë qenë minimale, për shkak se ka qëndruar familjarisht në banesën e familjes së origjinës, ku përfshihej fjetja dhe ushqimi dhe për shkak të gjendjes së shtatzënisë. Ky qëndrim është bërë për të qenë së bashku për shkak të aksidentimit dhe vdekjes së babait të bashkëshortit. Një ndër arsyet pse ka pasur të ardhura për shlyerjen e kredisë kanë qenë të ardhurat e realizuara nga familjarë, miq, shokë dhe kolegë, për shkak të kësaj tragjedie familjare.

### **Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

13. Komisioni, duke marrë në konsideratë faktet e dala nga hetimi, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe ligjin e zbatueshëm, vlerëson se disa nga pretendimet e subjektit në përgjigje të barrës së provës dhe gjatë seancës dëgjimore, të cilat provuan të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe mund të merren në konsideratë për efekt të analizës financiare, janë si më poshtë vijon:

#### **Për vitin 2012 do të merren në konsideratë:**

- i. Reduktimi i shpenzimeve vjetore të transportit në vendin e punës për shkak të pushimeve të festave zyrtare, ditëve me raport shëndetësor të fëmijëve, apo udhëtimeve të herëpashershme me kolegët, duke marrë në konsideratë pushimet vjetore prej 35 ditësh për magistratët, si dhe pushimet e festave zyrtare për vitin 2012.

#### **Për vitin 2014 do të merren në konsideratë:**

- ii. Shpenzimet e qëndrimit dhe akomodimit në shumën 3.700 lekë gjatë vizitës njëditore të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për turizëm në Ulqin (përkundrejt 50 Euro të përlllogaritura fillimisht), për shkak se subjekti vërtetoi me dokumentacion ligjor justifikues se bashkëshorti ka qëndruar te një i afërm në qytetin e Ulqinit<sup>33</sup>.
- iii. Reduktimi i shumës prej 10 000 lekësh më pak për shpenzime qiraje për muajin prill të vitit 2014.
- iv. Reduktimi i shpenzimeve vjetore të transportit në vendin e punës për shkak të pushimeve të festave zyrtare, ditëve me raport shëndetësor të fëmijëve, apo udhëtimeve të herëpashershme me kolegët, duke marrë në konsideratë pushimet vjetore prej 35 ditësh për magistratët, si dhe pushimet e festave zyrtare për vitin 2014.

#### **Për vitin 2015 do të merren në konsideratë:**

- i. Reduktimi i shpenzimeve për ushqimin e së bijës pasi ka ndjekur një shkollë, e cila e ka të përfshirë mengjesin dhe drekën, siç është e specifikuar edhe në kontratë.

---

<sup>33</sup> Dëftesë për deklaram qëndrimi /vërtetimin e rezidencës së personit tek i cili ka qëndruar bashkëshorti.

- ii. Reduktimi i shpenzimeve për udhëtimin në Greqi të bashkëshortit, pasi ai ka qëndruar te të afërmit e tij në Greqi, të cilët kanë marrë përsipër të gjitha shpenzimet, duke vërtetuar rezidencën dhe ftesën nga pala ftuese në Greqi.
- iii. Reduktimi i shpenzimeve jetike për bashkëshortin e subjektit për vitin 2015, pasi për shkak të statusit të ushtarakut është trajtuar me një pagesë shtesë mujore për ushqim, vërtetuar kjo me vërtetim nga Ministria e Mbrojtjes.

**Për vitin 2016 do të merren në konsideratë:**

- i. Reduktimi i shpenzimeve për ushqimin e së bijës pasi ka ndjekur një shkollë, e cila e ka të përfshirë mengjesin dhe drekën, siç është e specifikuar edhe në kontratë.
- ii. Reduktimi i shpenzimeve jetike për bashkëshortin e subjektit për vitin 2016, pasi për shkak të statusit të ushtarakut është trajtuar me një pagesë shtesë mujore për ushqim, vërtetuar kjo me vërtetim nga Ministria e Mbrojtjes.

14. Më tej, Komisioni, në lidhje me apartamentin e personit tjetër të lidhur/vjehrrës së subjektit të rivlerësimit, për një mungesë burimesh nga gjendja *cash* në shumën 489 500 lekë, vlerëson se subjekti provoi se personi tjetër i lidhur kishte përfituar dëmshpërblimin nga shoqëria e sigurimeve “INSIG” në shumën 600 000 lekë<sup>34</sup>, për vdekjen në mënyrë aksidentale të bashkëshortit të saj. Kështu që, në lidhje me këtë mungesë Komisioni vlerëson se personi tjetër i lidhur me subjektin ka pasur mundësi financiare nga burime të ligjshme për të blerë apartamentin në të cilin ka bashkëjetuar dhe kontribuar edhe subjekti i rivlerësimit.

15. Në referim të sa më lart dhe pas rishikimit të analizës financiare, duke marrë në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit ka një mungesë të të ardhurave nga burime të ligjshme për vitet 2006 – 2016, në shumën 687 842 lekë, siç paraqitet në tabelën e mëposhtme

**Tabela e analizës financiare 2006 – 2016**

Viti	Të ardhurat	Pasuri neto	Shpenzime	Detyrimet	Balanca vjetore
2006	930,904	493,568	348,014	331,195	<b>420,517</b>
2007	1,333,905	406,360	534,798	-259,184	<b>133,564</b>
2008	1,261,441	313,186	428,136	-72,012	<b>448,107</b>
2009	1,429,704	-231,898	700,072	0	<b>961,530</b>
2010	1,399,132	27,651	1,983,423	1,356,003	<b>744,062</b>
2011	1,522,930	-378,370	825,762	-38,719	<b>1,036,819</b>
2012	1,440,105	275,357	932,903	-532,616	<b>-300,770</b>
2013	1,477,776	-347,791	935,131	-433,827	<b>456,608</b>
2014	1,731,723	670,910	1,209,971	-100,842	<b>-249,999</b>
2015	1,828,577	2,982,108	1,554,749	2,573,739	<b>-134,541</b>
2016	2,094,875	-32,027	1,690,745	-438,688	<b>-2,532</b>
<b>TOTAL</b>	<b>16,451,071</b>	<b>4,179,054</b>	<b>11,143,702</b>	<b>2,385,050</b>	<b>3,513,366</b>

16. Trupi gjykues çmon se mungesa e likuiditeteve përgjatë viteve, pas analizës financiare të përditësuar në shumën 687 842 lekë, nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit, për vetë faktin se analiza financiare është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar pasaktësie në elementet që vlerëson, krahasuar me aspektet konkrete të jetës

<sup>34</sup> Vërtetuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2019, nga shoqëria “INSIG”.

reale. Për sa arsyetohet më sipër, trupi gjykues çmon se mungesa e këtij likuiditeti nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

17. Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

18. Komisioni, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e kësaj pamjaftueshmërie, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij. Komisioni konkludon se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

19. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur të provojë bindshëm burimin e krijimit të pasurive të saj për një apartament dhe një automjet, edhe pse ndër vite ka pasur deklaram të pasaktë, pasi ka mungesë të burimeve financiare për të mbuluar shpenzimet që ka kryer për 4 vjet, duke bërë analizën për harkun kohor të një 10-vjeçari. Këto pasaktësi gjatë këtyre katër viteve, sipas vlerësimit të trupit gjykues, nuk përbëjnë cenim të besimit të publikut dhe nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkim, sipas pikës 61/3, pasi deklarimi në deklaratën “Vetting” është i saktë dhe ka burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë e deklaruara nga burime të ligjshme.

## **VI. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KONTROLLIT TË FIGURËS**

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016.

2. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Ky raport është deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2018.

3. Si konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Sonila Muhametaj (Domi).

4. Pavarësisht raportit të dërguar nga DSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ, prej të cilit rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

5. Më tej, Komisioni konstatoi se nuk ka asnjë informacion apo *indicie* që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës, nuk ka denoncime apo të dhëna të tjera që të rezultojë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me

personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

**6. Në përfundim, Komisioni çmon se** subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar deklaratën për figurën në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016; nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

**7. Si konkluzion në sa më lart, Komision vlerëson se** subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

## **VII. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR AFTËSITË PROFESIONALE**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka dorëzuar raportin profesional për subjektin e rivlerësimit.

Nga vlerësimi i tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti dhe pesë dosjeve të përzgjedhura me short, lidhur me kriteret e vlerësimit, sipas ligjit nr. 96/2016, janë vënë re këto gjetje:

1. Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Sonila Muhametaj (Domi), tregon korrektësi në zbatimin e ligjit. Në tri aktet procedurale ligjore të paraqitura prej saj dhe në pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, është konstatuar se subjekti ka identifikuar drejt normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet. Në të gjitha rastet analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit.

2. Në vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurores Sonila Muhametaj (Domi), për vitet 2013, 2014 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se: (i) për vitin 2013 subjekti Sonila Muhametaj (Domi) është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej saj; (ii) për vitin 2014 subjekti Sonila Muhametaj (Domi) është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej saj; (iii) për vitin 2016 subjekti Sonila Muhametaj (Domi) është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej saj.

3. Subjekti i rivlerësimit, znj. Sonila Muhametaj (Domi) shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej saj janë të kuptueshme. Nga pikëpamja gjuhësore, ka respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit të përgatitur prej saj. Aktet e përpiluara prej saj janë të konceptuara përgjithësisht me tri pjesë. Përmbajtja e akteve u ka dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për zgjidhje. Në përmbajtjen e akteve procedurale rezulton se formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga prokurorja. Rezulton se konkluzioni i prokurores, në aspektin arsyetues, lidhur me konstatimin e faktit penal, mbështetet në analizimin dhe argumentimin e përgjithshëm të pasqyruar në një paragraf. Subjekti i rivlerësimit ka analizuar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mënyrën e caktimit të dënimit. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton në mënyrë rigorozë standardin e procesit të rregullt ligjor.



4. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të analizuara, rezulton se subjekti i rivlerësimit tregon vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara. Ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuara dhe me numrin total të çështjeve të përfunduara, për të gjithë periudhën e vlerësimit.

5. Subjekti i rivlerësimit, znj. Sonila Muhametaj (Domi), kryen veprime procedurale hetimore, të cilat rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet që veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese të subjektit të rivlerësimit u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat dhe aktet e nevojshme dhe duke konkluduar në një vendimmarrje. Lidhur me njoftimet e vendimmarrjeve konstatohet se është respektuar detyrimi për të kryer njoftimet përkatëse të subjekteve.

6. Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit.

7. Rezulton se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit, si dhe nuk janë paraqitur të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Nga dokumentet ligjore të analizuara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar.

8. Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t'u angazhuar, subjekti i rivlerësimit, prokurorja Sonila Muhametaj (Domi), i nënshtrohet programit të formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës. Lidhur me trajnime të tjera, të kryera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti i rivlerësimit, prokurorja Sonila Muhametaj (Domi), ka qenë pjesëmarrëse në disa aktivitete të zhvilluara, si brenda vendit, ashtu edhe jashtë vendit.

### **Konkluzione për rivlerësimin e aftësive profesionale**

Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv dhe konsiderohet “i aftë”.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Sonila Muhametaj (Domi), ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

## **VIII. TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE**

1. Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, si dhe të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se për subjektin e rivlerësimit, znj. Sonila Muhametaj (Domi), janë regjistruar:

- i. Vendimi nr. \*\*\*, datë 21.9.2018, “Për fillimin e hetimit disiplinor”, i nxjerrë nga Prokurori i Përgjithshëm, për prokuroren Sonila Muhametaj (Domi). Kjo vendimmarrje është bazuar në informacionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, datë 19.9.2018, “Mbi hedhjen e shortit”.

Nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta. Nuk ka të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së saj në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale).

- ii. Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2019, e **Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë**, e cila ka njoftuar se në ngarkim të subjektit **Sonila Muhametaj (Domi)** kjo prokurori ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*\*, të vitit 2018 nga shtetasi R.K. Kallëzuesi pretendon se djali i tij E.K. është arrestuar në mënyrë të padrejtë nga policia në mesnatën e datës 30.7.2016, teksa ishte duke fjetur, me pretekstin për një “verifikim” dhe më pas, sipas tij ky verifikim është kthyer në akuzë të padrejtë dhe pa prova nga policia e shtetit dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranën në datën 24.12.2018 ka arritur në përfundimin se “procedimi penal nuk mund të fillojë”, pasi fakti nuk ekziston dhe në bazë të germës “ç”, të nenit 290/1, dhe nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale është mosfilluar procedimi penal. Ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar e drejta e ankimit.
- iii. Praktika nr. \*\*\* e vitit 2016 nga shtetasja L.G. Konkretisht, kjo shtetase pretendon për zvarritje të hetimeve. Nga administrimi i kësaj praktike rezulton se procedimi penal nr. \*\*\*, me kallëzuese shtetasen L.G. (L.P.), është regjistruar në datën 8.4.2016 si procedim penal nga prokurorja A.S. Materiali kallëzues fillimisht i ka kaluar prokurores Sonila Muhametaj (Domi) dhe më pas, në datën 24.2.2016, duke qenë se “*me dekretin e presidentit të Republikës së Shqipërisë nr. \*\*\*, datë 18.2.2016, prokurorja Sonila Muhametaj është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda*”, është proceduar me zëvendësimin e prokurorit të çështjes, bazuar në nenin 27/1, të Kodit të Procedurës Penale, me prokuroren A.S.

2. Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e depozituara pranë Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe të gjithë aktet e tjera ligjore, të analizuara nga Prokuroria e Përgjithshme, ka të njëjtin vlerësim me të në lidhje me këto ankesa dhe vlerëson se ato nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

## **IX. DENONCIMET NGA PUBLIKU**

Për subjektin e rivlerësimit, znj. Sonila Muhametaj (Domi), në Komision janë administruar katër denoncime nga publiku, si më poshtë vijon:

1. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 24.6.2018, i shtetasit R.K., i cili denoncon subjektin e rivlerësimit dhe dy prokurorë të tjerë pranë Prokurorisë për Krimet e Rënda për arrestimin e djalit të tij në mënyrë të padrejtë, të cilët kanë kërkuar dënimin e të pandehurit pasi kanë dështuar në tentativën për të marrë shumën 50 000 euro.
2. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 12.8.2018, i shtetasve N.M. dhe S.M., të cilët ka bërë kallëzim penal për prokurorët Sonila Muhametaj, E.Sh., G.S., A.S. dhe B.H., për kryerjen e veprave

penale “shpërdorim detyre, në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 248/2, i Kodit Penal dhe “korrupsion pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionareve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç, i Kodit Penal.

3. Denoncimi për dosjen “Karaburuni”. Në Komision është administruar një denoncim nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, në lidhje me dosjen e pronave të Karaburunit, ku ndër të tjerë, përmendet edhe subjekti i rivlerësimit, znj. Sonila Muhametaj, lidhur me hetimet dhe gjykimet e zhvilluara në këtë dosje.

4. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 24.9.2019, me objekt “*Kërkoj të verifikohen prokurorët ... dhe Sonila Muhametaj, për çështjet e kallëzimit penal nr. \*\*\* dhe procedimit penal nr. \*\*\*, si të paafte në dhënien e vendimeve në shkëlqje të ligjit procedural dhe material.*”

Pasi mori në shqyrtim ankesat e depozituara nga publiku, lidhur me denoncimet e administruara, si dhe të gjithë aktet e tjera ligjore, Komisioni konstaton se nuk ka *indicie* dhe prova që të provohen faktet e pretenduara.

**Për sa më sipër, Komisioni**, pasi kreu hetim të hollësishëm lidhur me denoncimet, pasi analizoi shpjegimet e subjektit lidhur me to dhe pasi u shqyrtuan në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arriti në përfundimin se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

## **X. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Sonila Muhametaj (Domi), ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, dhe referuar germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Sonila Muhametaj (Domi), prokurore pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 25.10.2019.

## **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Genta TAFA (BUNGO)**  
**Kryesuese**

**Suela ZHEGU**  
**Anëtare**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Relatore**

*Sekretare gjyqësore*  
*Olsida Goxhaj*

